



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa: Rr "Reshit Çollaku"/ Pranë ILDKP, Tiranë
Tel: 042 220 466 / 99 Site: www.kkk.gov.al E_mail: info@kkk.gov.al

RAPORTI
i
VEPRIMTARISË

2019

P Ë R M B A J T J A

- 1. Hyrje**
- 2. Statusi, detyrat dhe organizimi**
 - 2.1 Statusi*
 - 2.2 Detyrat*
 - 2.3 Përbërja dhe organizimi*
- 3. Aktivitetet kryesore të vitit 2019**
 - 3.1 Përktimi i SNRF-ve*
 - 3.2 Përditësimi i SKK-ve*
 - 3.3 Hartimi i komentarit për ligjin e kontabilitetit dhe rregulloreve të tjera*
 - 3.4 Workshop, seminare dhe të tjera*
 - 3.5 Raporte dhe materiale të tjera në kuadër të integritit europian*
- 4. Gjetjet nga monitorimi i pasqyrave financiare**
- 5. Veprimtaritë dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit**
 - 5.1 BSNK, Londër*
 - 5.2 Banka Botërore*
 - 5.3 Organizatat e profesionit*
- 6. Objektivat për të ardhmen**
- 7. Plani i punës 2020**

Shtojcë A - Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare

Realizimi i buxhetit 2019

Parashikimi buxhetor 2020

Shtojcë B - Rezultate dhe rekomandime të auditimit të brendshëm të MFE

Shtojcë B – Monitorimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm

Aneks 1 - Pasqyrat financiare 2019

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
BE	Bashkimi Europian
BMP	Bordi i Mbikqyrjes Publike
BSNK	Bordi i Standardeve të Kontabilitetit
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IKM	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
KKK	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NVM	Njësi ekonomike të Vogla dhe të Mesme
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Europian
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
REPARIS	The Road to Europe: <i>Program of Accounting Reform and Institutional Strengthening</i>
SHKFSH	Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë
SHKM	Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

1. Hyrje

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizëm profesional, publik dhe i pavarur, ka si mision përmirësimin e vazhdueshëm të raportimit financiar të njësive ekonomike fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Ky mision, i zbërthyer në objektiva të qarta, strategji të përshtatshme dhe plane pune të koordinuara, garanton transparencën dhe saktësinë e raportimeve financiare si kusht i panegociueshëm i cilësisë së vendimeve ekonomike të operatorëve të tregut.

Produktet kryesore që realizon KKK-ja, në kuadër të detyrave të ngarkuara nga ligji i kontabilitetit, janë:

❖ **hartimi dhe përmirësimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit;**

Prej janarit 2008, kur për herë të parë u bënë të detyrueshme për zbatim SKK/ SNRF-të, Këshilli ka realizuar me shumë sukses shumë projekte profesionale. Në vitin 2009 publikohet për herë të parë një standard i raportimit financiar dedikuar mikronjësive ekonomike. Në vitin 2016 sërish publikohet një standard i ri i raportimit financiar, dedikuar njësive ekonomike jofitimprurëse që janë iniciativa joqeveritare. Shumë i rëndësishëm ishte dhe projekti i ndërmarrë nga KKK për rishikimin e thellë të SKK-ve në vitin 2013 për të publikuar më pas SKK-të e përmirësuara (2015). Në dallim me SKK-të e publikuara në 2008 të cilat ishin në koherencë me SNRF-të e plota, SKK-të e përmirësuara tashmë janë në koherencë të plotë me SNRF për NVM. Bashkë me SKK-të e përmirësuara u hartua për herë të parë edhe udhëzuesi për zbatim i secilit prej standardeve. Përmirësimi dhe përditësimi i SKK-ve është një proces i vazhdueshëm. KKK ka publikuar ndryshimet e SKK 2 “*Paraqitja e pasqyrave financiare*” dhe SKK 9 “*Kombinimi i bizneseve dhe konsolidimi*” me datë efektive 1 janar 2019 si dhe ndryshimet e një grupi tjetër standardesh përkatësisht SKK 3 “*Instrumentet financiare*”, SKK 5 “*AAM dhe AAJM*”, SKK 11 “*Tatimi mbi fitimin*” dhe SKK 13 “*Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare*”, të cilat kanë datë efektive 1 janar 2020.

❖ **përkthimi, pa ndryshime nga teksti origjinal dhe në kohë reale, i SNRF-ve;**

Paralelisht me hartimin dhe përditësimin e SKK-ve është realizuar me shumë përpikmëri dhe përkthimi i SNRF-ve dhe publikimi mbi baza vjetore i variantit të konsoliduar të SNRF-ve në gjuhën shqipe. Njësitë ekonomike të cilat kanë detyrimin të hartojnë pasqyra financiare sipas SNRF-ve kanë mundësinë (*minimalisht 1 vit para datës së zbatimit të detyrueshëm të tyre*), t'i gjejnë ato të publikuara në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të KKK-së.

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të këtyre produkteve, KKK ka për detyrë edhe monitorimin e zbatimit të këtyre standardeve nga njësitë ekonomike. Gjithashtu, si një organizëm rregullator në fushën e raportimit financiar, KKK përpunon sistemin dhe metodat kontabël. Në rast se është një nevojë e përdoruesve apo hartuesve të raporteve financiare, KKK formulon edhe udhëzimet përkatëse kontabël. KKK me ligj ka detyrimin të kontribuojë me mendime dhe sygjerime në hartimin apo amendimin e akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, me propozime konkrete për kurrikulat universitare që mbulojnë fushën e kontabilitetit si dhe të publikojë materiale informuese dhe udhëzuese në zbatim të standardeve të raportimit financiar.

Në vëmendje të KKK-së kanë qenë gjithnjë dhe zhvillimet e kontabilitetit dhe raportimit financiar në BE. Në vitin 2013, BE publikoi Direktivën e re të kontabilitetit e cila shfuqizoi Direktivën 4 dhe 7 të cilat respektivisht rregullonin raportimin financiar në pasqyrat financiare individuale dhe ato të konsoliduara. Pas publikimit të Direktivës së re të kontabilitetit, Direktiva 34/2013/EU, me ndihmën e programit REPARIS të Bankës Botërore u hartua tabela e përputhshmërisë mes Direktivës së re të kontabilitetit dhe kuadrit vendas të raportimit financiar. Tabela e përputhshmërisë nxorri në pah shumë diferenca, një pjesë e të cilave më pas, me iniciativën e KKK-së u transpozuan në ligjin e ri të kontabilitetit, Ligji nr 25/218 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Ligji i ri i kontabilitetit, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019, dëshmon një tjetër kontribut të KKK-së në përditësimin dhe përmirësimin e akteve ligjore. KKK propozoi një paketë ndryshimesh të ligjit të mëpasshëm të kontabilitetit të cilat mbanin në konsideratë disa elemente të rëndësishme si transpozimi i një pjesë të mirë të Dir 34/2013/EU, saktësimi i kërkesave për pasqyrat financiare të publikueshme dhe standardet përkatëse për hartimin e tyre, përditësimi i terminologjisë dhe caktimi i disa detyrave të reja për KKK-në.

2. Statusi, detyrat dhe organizimi

2.1 Statusi

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga buxheti i shtetit. KKK ka të drejtë të përdorë edhe të ardhurat që realizon nga punët që kryen. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Pjesë të këtij raporti ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda po këtij afati.

2.2 Detyrat

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- b) të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;
- d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;
- dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;
- e) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të

drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;

ë) të botojë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;

f) të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;

g) të organizojë tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike.

2.3 Përbërja dhe organizimi

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

- a) një anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;
- b) një anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;
- c) një anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;
- ç) tre anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;
- d) një anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe kanë mandat 4-vjeçar. Ata mund të rimandatohen vetëm një herë me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duhet të jenë persona me edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose financës, si dhe ekspertë në teorinë dhe metodologjinë e kontabilitetit ose praktikues në fushën e kontabilitetit. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të KKK-së përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të KKK-së”. Kryetari dhe nënkryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit zgjidhen nga anëtarët e këshillit, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore. Për realizimin e detyrave, anëtarët angazhohen me kohë jo të plotë pune.

Me Urdhër të Ministrit përgjegjës të Financave, nr 397/1, datë 26.11.2019 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, anëtarët e rinj të mandatuar të KKK-së janë:

Zj. Greta Angjeli, Kryetar

Zj. Ingrid Shuli, Nënkyetar

Zj. Vjollca Karapici, Anëtar

Zj. Eleonora Olli, Anëtar

Zj. Edlira Luçi, Anëtar

Z. Fatos Beqja, Anëtar

Zj. Alma Beja, Anëtar

Këshilli, në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të KKK-së”, neni 15, ngre Komisionet e veçanta të përhershme ose të përkohshme. Pranë KKK funksionojnë komisionet si më poshtë:

- Komisioni i përhershëm për çështjet e përkthimit, publikimit, zbatimit dhe monitorimit të SNRF-ve; (*Komisioni për SNRF-të*)
- Komisioni i përhershëm për çështjet e hartimit, përmirësimit, publikimit, zbatimit dhe monitorimit të SKK-ve; (*Komisioni për SKK-të*)
- Komisioni i përhershëm për çështjet e bashkëpunimit me Institucionet e tjera shtetërore; (*Komisioni për marrëdhëniet me të tretët*)
- Komisioni i përkohshëm për marrëdhëniet me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe implementimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me këto Institucione; (*Komisioni për marrëdhëniet me IAL*)

Në planin e punës për vitin 2020 është dhe ngritja e *Komisionit për Çështjet e Integritit*.

Veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit e mbështet një strukturë administrative me personel të punësuar. Struktura, organika, pagat për të punësuarit dhe honoraret e anëtarëve të këtij Këshilli miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në përbërje të strukturës administrative janë Drejtori i Përgjithshëm, tre specialistë të standardeve dhe dy staf mbështetës (financa dhe sekretaria).

3. Aktivitetet kryesore të vitit 2019

3.1 Përkthimi i SNRF-ve

Në zbatim të Ligjit nr 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 4, Këshilli përkthen, pa ndryshime nga origjinali në gjuhën angleze, SNRF-të e publikuara nga BSNK¹. SNRF-të e përkthyer në gjuhën shqipe shpallen të detyrueshme për zbatim me Urdhër të ministrit përgjegjës për financat. BSNK, sipas kontratës të lidhur në vitin 2007 me ministrinë përgjegjëse të financave, dërgon rregullisht mbi baza vjetore, pranë KKK-së, të gjitha SNRF-të e publikuara. Detyrimi i KKK-së për këtë kontratë është pagesa e tarifës vjetore.

Materialet e ardhura nga BSNK përkthehen dhe rishikohen nga Komiteti i Rishikimit. Komiteti i Rishikimit përbëhet nga 4 (katër) anëtarë, dy përkthyes dhe dy rishikues. Mandati i tyre është 2 vjeçar me të drejtë rikandidimi. Miratimi i anëtarëve të Komitetit të Rishikimit bëhet nga KKK-ja. Përkthyesit ofrojnë shërbim kundrejt pagesës ndërsa rishikuesit e ofrojnë këtë shërbim në mënyrë vullnetare. Komiteti i Rishikimit aktual ka në përbërje përkthyes Zj. Valbona Kapllani, Dr dhe Z. Artan Xhiani (Auditues ligjor) dhe rishikues Z. Hysen Çela, Prof (Auditues ligjor) dhe Zj. Orjana Kalaja (Auditues ligjor). Mandati i tyre përfundon në tetor 2020.

SNRF-të, përditësimet e tyre apo SNRF-të e reja, dërgohen rregullisht nga BSNK. Ndërkohë, stafi i KKK-së koordinon procesin e dërgimit për përkthim dhe rishikim. Përkthimi bëhet me programin TRADOS, një software shumë i avancuar përkthimi. Afatet e përkthimit dhe rishikimit janë jo më shumë se 6 muaj. Materialet e përkthyer dhe të rishikuara administrohen sërish nga stafi i KKK-së i cili përmes programit TRADOS e konsolidon materialin e përkthyer në variantin e mëparshëm të SNRF-ve. Varianti në gjuhën shqipe të SNRF-ve të përditësuar publikohet mbi baza vjetore në faqen e internetit të KKK-së.

Për vitin 2019, janë përkthyer, rishikuar dhe shpallur për zbatim materialet e publikuara nga BSNK gjatë vitit 2018, më poshtë:

¹ BSNK – Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Londër

Titulli	Data Efektive
27100_EN_GVT_Amendments_to_IAS_19 Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 19 <i>Përfitimet e punonjësve</i>	Pas 1 Janar 2019
84606 EN GVT Amend IAS 1 and IAS 8 Ndryshime në SNK 1 dhe SNK 8 <i>Përkufizimi i Materialitetit</i>	Pas 1 Janar 2020
38279 EN GVT Definition Of Business Oct 2018 Ndryshime në SNRF 3 <i>Përkufizimi i biznesit</i>	Pas 1 Janar 2020

Gjithashtu, gjatë 2019 kanë mbërritur edhe përditësimet 2019 të bëra nga BSNK të cilat do të përkthehen, rishikohen dhe dërgohen për shpallje të ministri përgjegjës për financat, gjatë vitit 2020.

3.2 Përditësimi i SKK-ve

Gjatë vitit 2018-2019, u rishikuan SKK3 *Instrumentet financiare*, SKK5 *Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale*, SKK 11 *Tatimi mbi të ardhurat*, SKK 13 *Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare* si dhe SKK15 *Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të mikronjësive*. Përmirësimet e bëra në këto standarde janë produkt i kërkesave të ligjit të ri të kontabilitetit, Ligji nr 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe të frymës së Direktivës 34/2013/EU, e ndryshuar, që në themel të filozofisë së saj ka reduktimin e barrës së raportimit financiar të njësive të vogla dhe shumë të vogla (mikro).

Me Urdhër nr 175, datë 14.05.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë u shpallën të detyrueshme për zbatim ndryshimet e SKK 3, SKK 5, SKK 11 dhe SKK 13, me datë efektive janar 2020.

SKK5 dhe SKK 13 janë ndryshuar për të hequr për njësitë ekonomike të vogla, kërkesën e aplikimit të modelit të vlerës së drejtë në vlerësimin e mëpasshëm të aktiveve afatgjata, materiale dhe jomateriale (në përdorim apo të investuara) si dhe atyre biologjike. Njësitë ekonomike të vogla do të vlerësojnë këtë grup aktivesh vetëm me modelin e kostos ose koston së amortizuar.

SKK 3, u ndryshua për të reflektuar kërkesat e Direktivës 34/2013/EU për njohjen, matjen dhe vlerësimin e instrumenteve financiare komplekse. Në variantin e përmirësuar 2020 të SKK 3, kërkohet që për instrumentet e thjeshta të vazhdojë të aplikohet modeli i koston ndërsa për instrumentet financiare komplekse të zbatohet modeli i vlerës së drejtë duke dhënë instruksionet përkatëse për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentit financiar.

SKK 11, u ndryshua për të hequr për njësitë ekonomike të vogla, kërkesën e aplikimit të detyrueshëm të tatimit të shtyrë. Ky grup njësisish ekonomike zbaton vetëm rregullimet në standard që mbulojnë njohjen, matjen dhe paraqitjen e tatimit aktual mbi fitimin.

Me Urdhër nr 56, datë 15.02.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë u shpall i detyrueshëm për zbatim SKK 15, i përmirësuar, i ndryshuar, me datë efektive janar 2019. **SKK15**, u ndryshua për të reflektuar ndryshimin e bërë në ligjin e ri të kontabilitetit për riklasifikimin e njësive ekonomike në njësi mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Meqenëse në ligj kriteret e klasifikimit të njësive ndryshuan, ato duhej të reflektoheshin edhe në kërkesat e SKK15. Ndryshimi tjetër i rëndësishëm në SKK 15 është heqja e alternatives së mbajtjes së kontabilitetit monetar nga mikronjësitë me një xhiro më pak se 2 (dy) milion lekë në vit. Të gjitha njësitë ekonomike mikro, sipas SKK 15 (përmirësuar 2019) kanë detyrimin të zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara nëse realizojnë një xhiro vjetore mbi 5 (pesë) milion lekë. Në të kundërt, sipas Standardit, mikronjësitë me një xhiro vjetore nën 5 (pesë) milion lekë nuk hartojnë pasqyra financiare, pra nuk kanë detyrimin të mbajnë kontabilitet.

Me Urdhër nr 28, datë 30.01.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë u shpallën të detyrueshme për zbatim ndryshimet e SKK 2 dhe SKK 9 të përmirësuara, me datë efektive janar 2019. Për këto ndryshime, gjatë vitit 2019, u përgatitën bazat për konkluzione të cilat u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KKK-së në fund të muajit shkurt 2019.

Gjithashtu, me daljen e Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për shpalljen e ndryshimeve të SKK 15, u përgatit baza për konkluzione e këtyre ndryshimeve. Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të internetit të KKK-së.

3.3 Hartimi i udhëzuesve në zbatim të ligjit të kontabilitetit

Dokumentet e realizuara nga KKK gjatë vitit 2019 janë:

- **Komentari për ligjin e kontabilitetit 25/2018**
- **Raporti i performancës së OJF-ve**

Komentari për ligjin e kontabilitetit 25/2018. Me qëllim zbatueshmërinë korrekt të ligjit për kontabilitetin, KKK mori vendimin të hartojë komentarin për Ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në 6-mujorin e parë u punua për draftimin e tij sipas parimit për të ilustruar me shembuj apo interpretuar secilin prej neneve dhe paragrafëve të ligjit, por duke e vënë më së shumti theksin tek kërkesat e prezantuara rishtazi në këtë ligj. Stafi solli në secilën prej mbledhjeve të rradhës të Këshillit, materialin draft në proces i cili në mbledhjen e muajit qershor u miratua si draft për t’u publikuar për komente në faqen zyrtare të internetit. Në draft komentarin e publikuar online dhe më pas të dërguar me postë elektronike në adresat e organizmave profesionalë apo shoqërive të auditimit, komentet e ardhura nga palët e interesuara u përfshinë në masën që u gjykuan nga KKK si vlerë e shtuar për dokumentin. Gjithashtu nga KKK u ndërmor iniciativa e organizimit të një tryeze të rrumbullakët sërish me pjesëmarrje të palëve të interesit ku debati i drejtpërdrejtë mund të ishte më efektiv. Diskutimet në tryezë, pyetjet, komentet apo sugjerimet, u përmbledhën dhe u ridiskutuan në mbledhjen e rradhës të KKK-së. Për sa u pa e arsyeshme u bënë disa ndërhyrje në komentarin draft dhe më pas në mbledhjen e muajit shtator 2019 u mor vendimi që komentari, varianti i përfunduar, të publikohej në faqen zyrtare të internetit² të KKK-së si një dokument pune në zbatim të ligjit të ri për kontabilitetin. Komentari nuk ka fuqi ligjore, pra nuk është pjesë e hierarkisë së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të kontabilitetit, për një dokument pune me të cilin profesionistët

² http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Komentari%20ligji%2025-2018%20i%20publikuar_1.pdf

mund të konsultohen në punën e tyre në rastet kur duhet të zbatojnë kërkesat e këtij ligji. Komentari është një dokument që mund të pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me interpretime dhe shembuj praktikë nëse palët e interesuara paraqesin kërkesa në KKK për një gjë të tillë.

Raporti i performancës së OJF-ve. Ligji i ri “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në nenin 22 (3), ngarkon KKK-në të hartojë raportin e performancës së OJF-ve të cilat duhet ta publikojnë atë në ëbsite-n e tyre bashkë me pasqyrat e tjera financiare. Detyrimin për hartimin e këtij raporti e kanë OJF-të që kanë shifrën e aktivitetit apo të të ardhurave më të madhe se 30 milion lekë. Qëllimi kryesor i raportit të performancës është të sigurojë që një organizatë jofitimprurëse të jetë publikisht e përgjegjshme ndaj palëve të interesuara për administrimin dhe menaxhimin e fondeve që ka në dispozicion. Raporti i Performancës të OJF-së duhet të sigurojë një përmbledhje të drejtë, të ekuilibruar dhe të kuptueshme të strukturës së saj, qëllimeve sociale, objektivave, aktiviteteve, performancës financiare dhe pozicionit financiar. Raportimi i mirë shpjegon se për çfarë është krijuar organizata jofitimprurëse, si po shkon ecuria dhe çfarë arrihet si rezultat i punës së saj. Raporti i performancës duhet të ndihmojë përdoruesit e mundshëm që të marrin vendime ekonomike në lidhje me OJF-në, të vlerësojnë progresin e OJF-së ndaj objektivave dhe të kuptojnë planet e saj në lidhje me qëllimet sociale. Raporti i performancës dhe pasqyrat financiare të marra së bashku duhet të japin një pamje të asaj që ka bërë një OJF (*produktet e aktivitetit të saj*) ose të asaj që ka arritur (*rezultatet e saj*), ose çfarë ndryshimi ka sjellë (*ndikimi i saj*). Raport i Performancës, draftuar nga KKK, është në fazën e miratimit dhe do të publikohet për zbatim në faqen zyrtare të KKK-së. Drafti parashikon që ky raport mund të hartohet dhe paraqitet i ndarë në kapitujt e mëposhtëm:

- objektivat dhe aktivitetet;
- arritjet dhe performanca;
- raportimi financiar;
- struktura, qeverisja dhe menaxhimi.

Përgjegjësia për miratimin e raportit i takon Bordit të OJF-së (ose një organi ekuivalent). Bordi i'a kërkon stafit apo drejtuesve / këshilltarëve hartimin e Raportit të Performancës, por Bordi në tërësi, ose një anëtar i emëruar i Bordit që vepron në emër të tij, duhet të miratojë tekstin përfundimtar të Raportit të Performancës duke e nënshkruar dhe datuar.

Në ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pika 1, parashikohet që KKK-ja harton *rregulloren e inventarizimit*, e zbatueshme për njësitë ekonomike subjekt i këtij ligji, për të kontrolluar të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, detyrimeve dhe të kapitaleve të veta. Gjatë vitit 2018 dhe 2019, KKK e ka rimarrë disa herë në diskutim këtë çështje për të arritur në përfundimin se çfarë duhet të përmbajë në parim një rregullore e tillë. Në Këshill nuk ka patur një qëndrim të unifikuar dhe diskutimet kanë qenë lidhur me:

- nevojën dhe dobinë e një dokumenti të tillë;
- shkallën e detajimit të kërkesave të kësaj rregullore;
- fushën e saj të zbatimit;
- të qenurit e detyrueshme për zbatim nga të gjitha njësitë ekonomike;
- etj.

KKK-ja nuk mori vendim gjatë 2019 për të vazhduar me diskutime edhe gjatë vitit 2020.

3.4 Workshop, seminare dhe të tjera



Workshop – Raporti i performancës së OJF-ve. Në datë 10 prill 2019, KKK organizoi me përfaqësues të OJF-ve, që plotësonin kriteret e nenit 22 pika 3 të ligjit të ri të kontabilitetit, një tryezë të rumbullakët, me synim përfshirjen e palës kryesore të interesit në konceptimin e formatit dhe përmbajtjes së Raportit të Performancës së OJF-ve. Raporti i performancës publikohet së bashku me pasqyrat financiare në websiten e OJF-së në rast se OJF tejkalon shifrën 30 milion lekë të të ardhurave (fondeve të qarkulluara) vjetore ose të aktivitetit. Në tryezë morën pjesë rreth 30 përfaqësues të OJF-vë që plotësonin kriterin e hartimit të Raportit të Performancës. Në tryezë u paraqit një draft i konceptuar nga stafi i KKK-së dhe dakordsuar nga anëtarët e Këshillit. Përfaqësuesit e OJF-vë në përgjithësi mbajtën një qëndrim rezistent ndaj kësaj kërkesë të re ligjore duke e konsideruar një barrë shtesë në raportimin financiar të OJF-ve. Me një letër drejtuar instancave më të larta të shtetit, OJF-të paraqitën këtë shqetësim të dalë nga tryeza duke kërkuar kështu heqjen e kësaj kërkesë të ligjit. Pas takimit të organizuar nga zv. Ministri i

Financave dhe Ekonomisë, z. Enton Haxhi, me një përfaqësi të OJF-ve, përfundimisht KKK-së i'u kërkua të vazhdojë me draftimin e raportit të performancës për t'ua vënë në dispozicion OJF-ve për raportimin financiar të vitit 2019.



Tryezë e rrumbullakët – Problematikat në zbatimin e ligjit të ri të kontabilitetit. Në datë 15 maj 2019, u organizua tryeza e rrumbullakët me fokus analizën e problematikave të shfaqura në fillimet e zbatimit të ligjit të ri të kontabilitetit. Në tryezë morën pjesë rreth 40 pjesëmarrës përfshirë

profesionistë të kontabilitetit, drejtues dhe anëtarë të shoqatave të profesionit, përfaqësues nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, përfaqësues të shoqërive të mëdha të auditimit, akademikë të fushës si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (sektori i kontabilitetit dhe DPT). Në tryezë pati shumë diskutime të cilat i dhanë input stafit të KKK-së për komentarin mbi ligjin. Problematikat e konstatuara nga zbatuesit e ligjit konsistojnë kryesisht në çështjet si më poshtë:

- Ku fillon përgjegjësia e atij që harton PF si dhe përgjegjësia e drejtimit?
- Kur do të hartohet një rregullore për inventarizimin dhe cili është formati i saj i parashikuar?
- Raporti i ecursisë së veprimtarisë – a është e mundur të përgatitet një akt nënligjor për të përjashtuar nga ky detyrim edhe njësitë ekonomike të mesme?
- Programet e informatizuara kontabël të shoqërisë do të jenë të autorizuara apo miratuara?
- Kush i vendos masat administrative?
- Çfarë është marrë parasysh që është ulur numri nga 9 në 7 i anëtarëve të KKK-së? Përfaqësimi nga universitetet pse nuk u pa më i arsyeshëm?
- Nëse ligji kërkon zbatimin e SKK/SNRF-ve dhe nga ana tjetër ka kërkesa për informacione shtesë, cila do të jetë baza e përgatitjes së pasqyrave financiare, SKK/SNRF apo SKK&SNRF&Ligji?
- Po raporti i pagesave për institucionet shtetërore (i veçantë) ku do të dorëzohet dhe brenda cilit afat?
- Në lidhje me VKM-në për njësitë me interes publik, a mund të jepen më shumë udhëzime dhe shembuj të rasteve kur këto njësi kanë detyrimin ose jo të zbatojnë SNRF-të?
- Në komentarin të përfshihet sqarimi për rastet kur mikronjësitë bien nën shifrën 5 milion apo kur rriten mbi 5 milion cilat PF do të bëjnë. A duhet të mbajnë parasysh periudhën tranzitore 2 vjet rradhazi?

- Të sqarohet më tej se si duhet të veprohet në rastet kur një njësi ekonomike e cila ka aplikuar më parë SNRF nuk i përmbush më për dy vite rradhazi kushtet për të zbatuar SNRF por SKK, atëherë si do të trajtohen diferencat midis SNRF dhe SKK në datën e tranzicionit?
- Si duhet interpretuar neni 18, pika 5? Audituesi a kryen shërbim auditimi apo vetëm verifikon parimisht nëse njësia ekonomike ka hartuar raportin jofinanciar?
- Si duhet zbatuar ky ligj duke mbajtur parasysh kontradikën mes nenit 17(3c) dhe nenit 22(3)?

Këto diskutime apo paqartësi në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit u vlerësuan në mbledhjet e rradhës së KKK-së dhe për aq sa nuk kërkonin ndërhyrje në akte apo nënakte ligjore u parashikuan të shpjegoheshin në komentarin për ligjin e kontabilitetit.



Tryezë e rumbullakët – Rregullorja e inventarizimit të aktiveve/detyrimeve.

Në datë 5 korrik 2019, u zhvillua një tryezë e rumbullakët me temë “Rregullorja e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve”. Në tryezë morën pjesë rreth 50 pjesëmarrës si përfaqësues të departamenteve të kontabilitetit në njësi ekonomike private dhe publike, tregtare dhe prodhuese, me kapital vendas ose të huaj, me dhe pa interes publik. Kryesisht pjesëmarrësit në tryezë ishin njohës shumë të mirë dhe me eksperiencë të procesit të inventarizimit. Diskutimet ishin të shumta, por pothuaj të gjitha konvergonin në një përfundim që është e pamundur të realizohet një dokument që të kënaqë nevojat e të gjithë njësisve ekonomike për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve. Një pjesë e diskutimeve ishin në parim si p.sh.:

- A duhet të jetë kjo rregullore e detyrueshme?
- A duhet të kemi një rregullore që rregullon detaje apo linja kryesore?
- Cili është objekti i rregullores?

Ndërsa pjesa tjetër e diskutimeve fokusohej në karakteristikat e ndryshme sektoriale të njësisve ekonomike duke dhënë evidencë të mjaftueshme për të mbështetur konkluzionin e tyre që një rregullore unike inventarizimi nuk mund të jetë e vlefshme për të gjitha njësitë ekonomike. Në përmbyllje të tryezës, KKK-ja u angazhua të vijojë me diskutimet teknike edhe me profesionistë dhe akademikë të tjerë në mënyrë që të arrihet në një konkluzion se çfarë duhet të parashikojë rregullorja e inventarizimit.



Workshop – SKK-të apo SNRF për NVM-të. Në datë 8 nëntor 2019 u zhvillua një workshop me fokus rihapjen e debatit me profesionistët për setin e standardeve të aplikueshme për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme. Në ëorkshop morën pjesë rreth 80 profesionistë të aderuar në shoqatat e profesionit IKM dhe SHKFSH. Në takim stafi prezantoi një material informues krahasues të dallimeve mes SKK-ve dhe SNRF për NVM. Materiali bënte një paraqitje të seksioneve të SNRF për NVM që janë përfshirë në SKK-të dhe të atyre të papërfshira. Gjithashtu, në material bëhej dhe një analizë më e detajuar duke dhënë për secilin seksion të përfshirë në SKK-të ato paragrafë të tij që nuk ishin integruar.

Seksionet e papërfshira ishin:

Seksioni 1 – Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme

Seksioni 22 – Detyrimet dhe kapitali

Seksioni 26 – Pagesat e bazuara në aksione

Seksioni 28 – Përfitimet e punonjësve

Seksioni 31 – Ekonomitë hiperinflacioniste

Dallimet e prezantuara në material, si përsa i përket seksioneve të papërfshira ashtu dhe paragrafëve të veçantë, ishin baza mbi të cilën u ngritën diskutimet e pjesëmarrësve në takim. Ëorkshopi zgjati rreth 3 orë dhe në përgjithësi diskutimet konverguan në qëndrimin që Shqipëria duhet të vazhdojë të aplikojë standardet kombëtare të kontabilitetit.

3.5 Raporte dhe materiale të tjera

a) Në kuadër të integrimit europian

Tabela e përputhshmërisë. Nga analiza e tabelës së përputhshmërisë përgatitur nga stafi i Bankës Botërore në vitin 2017, rezultuan shumë dispozita të paintegruara në kuadrin ligjor dhe të raportimit financiar në vendin tonë. Një pjesë e këtyre ndryshimeve u reflektuan në ligjin e ri të kontabilitetit që hyri në fuqi në 1 janar 2019. Pjesa tjetër e paragrafëve të patranspozuar është parë e arsyeshme të jetë pjesë e standardeve kombëtare të kontabilitetit. Disa prej këtyre

paragrafëve u përfshinë në SKK 2 dhe SKK 9 (të rishikuar) ndërsa pjesa e mbetur janë konsideruar nga KKK si kërkesa të parakohshme për zhvillimet në mjedisin shqiptar të raportimit financiar. Në muajin korrik 2019 i është dërguar zyrës së Bankës Botërore në Vienë tabela e re e përputhshmërisë mes Direktivës 34/2013/EU dhe Ligjit për kontabilitetin/SKK-ve përgatitur nga stafi i KKK-së. Informacioni i dërguar është një nga bazat mbi të cilën ka punuar stafi në Vienë për vlerësuar shkallën e transpozimit të Direktivës.

Një rekomandim i BB, drejtuar KKK-së dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Kontabilitetit, pas misionit të kryer gjatë muajit nëntor, është të vazhdojë reduktimi i kërkesave për shënime shpjeguese të njëjësive ekonomike të vogla. Në plotësim të këtij rekomandimi, KKK gjatë vitit 2020 do të rishikojë të gjitha kërkesat për shënime shpjeguese që janë parashikuar në SKK 1 – SKK 14, me qëllim që t'i përafrojë dhe reduktojë ato në përputhje me sa kërkohet në Direktivën Dir 34/2013/EU.

Plani Kombëtar i Integritimit European (PKIE) 2020 – 2021. Gjatë vitit 2019 stafi është angazhuar në plotësimin e kërkesave të MEPJ dhe MFE për përgatitjen e informacioneve për Kapitullin 6 (Legjislacioni Tregtar) ku paraqiten dhe adresohen zhvillimet më të fundit në KKK, adresimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian dhënë gjatë vitit 2018, prioritetet për vitin 2019 dhe objektivat afatmesëm 2020-2021;

b) Në kuadër të reformës së përmirësimit të raportimit financiar në Shqipëri

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS). Një përfaqësues i stafit të KKK-së, zj. Bundo, është zgjedhur pjesë e grupit të punës të angazhuar në kuadër të një projektit Reforma në Menaxhimin Financiar Publik (PFMRP) financuar nga Banka Botërore, për përgatitjen e standardeve të kontabilitetit në sektorin publik. Angazhimi i stafit ka qenë efektiv sidomos në kontributin e dhënë në takimet e zhvilluara me ekspertin e huaj të caktuar nga MFE kur hartohet drafti strategjia e përgatitjes dhe implementimit të standardeve të kontabilitetit në Sektorin Publik.

A&A ROSC. Nisma *Raporti mbi Vëzhgimin e Standardeve dhe kodeve (ROSC)*³ filloi në 1999 si një komponent i dallueshëm i përpjekjeve për të forcuar arkitekturën financiare ndërkombëtare. Nisma ROSC administrohet nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), të cilët kanë njohur standarde ndërkombëtare në 12 fusha. Banka Botërore përqendrohet në tre nga këto: Kontabiliteti dhe Auditimi; Qeverisja e Korporatave; Falimentimi dhe të drejtat e kreditorit.

Në muajin shkurt, një ekspert i Bankës Botërore, zj. Maryam Salim, Eërl Bank Country Manager for Albania, mori takim me KKK-në në kuadër të përgatitjes së *Accounting and Auditing Report on the Observance of Standards and Codes (A&A ROSC)*. Fillimisht është plotësuar një pyetësor gjithëpërfshirës⁴ në lidhje me vlerësimin e situatës aktuale në Shqipëri në lidhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në Shqipëri, zbatueshmërinë dhe monitorimin e tij. Më pas konsulenti zhvilloi me KKK-në edhe takime të tjera informuese deri në përgatitjen e draftit të ROSC. Në shtator të vitit 2019, drafti i'u dërgua sërish KKK për komente përfundimtare. Dokumenti⁵ është publikuar në Shkurt 2020.

c) Zbatimi i programit të transparencës

Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, stafi përditëson programin e transparencës me frekuenca tre mujore. Publikohen në faqen e internetit regjistri i prokurimeve (parashikimi dhe fakti) si dhe shpenzimet buxhetore. Në linkun përkatës publikohen njoftimet e rëndësishme të Këshillit. Për vitin 2019 gjithçka është publikuar sipas kërkesave të ligjit të sipërcituar.

d) Kthim përgjigje subjekteve

Është kthyer në një rutinë normale pune që njësi ekonomike të ndryshme i drejtohen me shkresë, me email ose në telefon stafit të KKK për interpretime apo sqarime lidhur me standardet kombëtare të kontabilitetit apo udhëzuesin në zbatim të tyre. Përgjigjet, në varësi të komunikimit të zgjedhur nga njësitë ekonomike, dërgohen me shkresa, me postë elektronike, përmes telefonit apo takime në zyrë. Frekuenca dhe intensiteti i këtyre komunikimeve është gjithnjë në varësi të

³ <https://www.worldbank.org/en/programs/rosc>

⁴ <file:///C:/Users/User3/Downloads/113029-ROSC-P155125-ROSC-AA-2-0-Module-B-Institutional-Framework-B-8-Accounting-Standards-Setting-KKK.pdf>

⁵ <http://documents.worldbank.org/curated/en/602231581090011333/pdf/Albania-Report-on-the-Observance-of-Standards-and-Codes-on-Accounting-and-Auditing.pdf>

periudhave të raportimit fiskal dhe atij financiar, kryesisht tremujori i parë i vitit ose afër fundit të 6 mj të parë të vitit, dy momente kohe të cilat lidhen me raportimin e njësive ekonomike për qëllime fiskale dhe atë raportimit financiar. Numri i kontaktimeve nga një vit në tjetrin vjen në rritje. Ky tregues flet nga njëra anë për një rritje të shkallës së ndërgjegjësimit të njësive ekonomike për rëndësinë e zbatimit cilësor të standardeve të kontabilitetit dhe nga ana tjetër për reputacionin e mirë dhe njohjen e KKK-së si organizmi i vetëm profesional standard hartues.

Të gjitha detyrat sa më sipër janë realizuar në kohë. Aktualisht janë shpallur për zbatim të gjitha SKK-të e rishikuara në 2019, janë publikuar bazat për konkluzione të këtyre standardeve të rishikuar, është në proces miratimi përfundimtar nga KKK edhe raporti i performancës së OJF-ve, janë përmbyllur tryezat e rrumbullakëta (*por pa u limituar vetëm tek ato të parashikuara në programin e punës 2019*), është dërguar për vlerësim në zyrat e Bankës Botërore në Vienë tabela e rishikuar e transpozimit të Dir 34/2013/EU si dhe është monitoruar zbatimi i SKK-ve/SNRF-ve në pasqyrat financiare të disa njësive ekonomike.

E vetmja detyrë e papërfunduar në vitin 2019 është përgatitja e një udhëzuesi (check list) për lidhjen mes zërave të pasqyrave financiare të hartuara sipas SKK 2 dhe paragrafëve të SKK-ve. Këshilli vendosi që kjo detyrë të shtyhej për vitin 2020 me qëllimin për t'u angazhuar në një detyrë të re, të paparashikuar për vitin 2019. Këshilli hartoi komentarin për ligjin e ri të kontabilitetit, detyrë e cila përfundoi brenda vitit 2019 me publikimin e komentarit në websiten e KKK-së.

4. Gjetjet nga monitorimi i pasqyrave financiare të periudhave raportuese 2017 dhe 2018



Stafi gjatë vitit 2019, në zbatim të kërkesës së re të ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” është fokusuar më fort në monitorimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike duke i siguruar ato nga faqja zyrtare e QKB-së. Përzgjedhja e njësive ekonomike bëhet e rastësishme. Problem në këtë procedurë është fakti që për rreth 60% të njësive ekonomike nuk gjejmë të publikuara pasqyrat financiare vjetore në ëeb-in e QKB-së. Gjithashtu, problem që i përket absolutisht të gjitha njësive ekonomike është fakti që nuk është i mundur aksesimi në shënimet shpjeguese të pasqyrave të tyre financiare. Me software-in e ri të

instaluar nga QKB pritet që të eliminohet problemi teknik i faqes së QKB-së në lidhje me publikimin e shënimeve shpjeguese. Meqenëse stafi nuk disponon shënimet shpjeguese të njësisë ekonomike, për të kuptuar më shumë mbi pasqyrat financiare, shfrytëzon edhe raportet e auditimit.

Një pengesë reale në punën e stafit është informacioni për numrin e punonjësve. Në shumë pak raste stafi bie në kontakt me këtë informacion nga sa gjen në QKB sepse në të shumtën e rasteve duhet të hyjë në komunikim të drejtpërdrejtë me njësitë ekonomike apo me audituesit e tyre për të gjetur informacion për punonjësit. Ky informacion është shumë i rëndësishëm kur stafi vlerëson nëse njësia ekonomike ka zbatuar ose jo standardet e duhura të raportimit financiar referuar kritereve të të ardhurave, aktivitetit dhe numrit të punonjësve.


Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të kontabilitetit, KKK ka detyrën dhe autoritetin të monitorojë zbatimin e SKK-ve/SNRF-ve dhe në konkluzion të gjetjeve të bëjë përmirësimet e duhura duke plotësuar materialet e publikuara me udhëzime apo ilustrime shtesë apo duke rekomanduar shoqatat e profesionit të fokusohen në trajnime të aspekteve të caktuara.

Njësitë e marra në shqyrtim për periudhën raportuese 2017, gjithsej kanë qenë 353 njësi, ndërsa njësitë e marra në shqyrtim për periudhën raportuese 2018, kanë qenë 60 njësi. Standardet e aplikuara nga këto njësi ekonomike jepen në grafikët më poshtë:



Gjatë monitorimit u konstatuan edhe disa mangësi si më poshtë:

- Një numër i caktuar njësish ekonomike, që sipas ligjit kanë detyrimin të publikojnë raportin e auditimit, nuk e kanë plotësuar këtë kërkesë. Respektivisht për pasqyrat e monitoruara, 353 njësi që janë monitoruar për periudhën raportuese 2017 dhe 60 njësi të monitoruara për periudhën raportuese 2018, informacioni është si më poshtë:



Gjithashtu janë vërejtur problematika edhe në plotësimin e pasqyrave financiare.

- Në 2 (dy) raste pasqyra e performancës (të ardhura/shpenzime) nuk është hartuar sipas kërkesave të SKK2 e përmirësuar;
- Në 4 (katër) njësi ekonomike në pasqyrën e pozicionit financiar ka mosrakordim midis shifrave të aktivitetit me totalin e detyrimeve dhe kapitalit për vitet 2016-2017;
- Në 6 (gjashtë) njësi ekonomike pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse është plotësuar gabim;
- Në 28 (njëzetë tetë) njësi ekonomike pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse mungon ose është e paplotësuar;
- Në një rast nuk përputhet informacioni financiar i pasqyrave të të njëjtës periudhë raportuese por publikuar në QKB në dy formate (pdf dhe excel);

Ndërsa një gjetje serioze, evidentuar gjatë monitorimit, është pasaktësia në dy raste e njësive ekonomike që zbatojnë setin e gabuar të standardeve të raportimit. Në të dyja rastet, njësitet ekonomike plotësojnë kushtet për të zbatuar SNRF-të por zbatojnë SKK-të. Seti i detyrueshëm i standardeve, për periudhat e monitoruara 2017 / 2018 ka qenë i përcaktuar në ligjin e shfuqizuar të kontabilitetit Ligji nr 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në VKM 742, datë 07.11.2007 të shfuqizuar (kriteret e zbatimit të SNRF-ve kanë qenë: të ardhura mbi 1.250.000 mijë lekë dhe mbi 100 të punësuar).

Në mungesë të shënimeve shpjeguese, stafi merr informacion edhe nga raportet e auditimit që njësitet ekonomike kanë publikuar bashkë me pasqyrat financiare vjetore. Përveç sa është konstatuar nga Inspektori i monitorimeve, disa nga opinonet me rezervë të audituesve për mangësi të pasqyrave financiare përmblihen si më poshtë:

- Nuk krijohen provizione në pasqyra për detyrimet që ka pasiguri për shumën apo kohën e shlyerjes;
- Shuma e kapitalit aksioner e paraqitur në pasqyrat financiare nuk përputhet me shumën e kapitalit aksionar të deklaruar në QKB;
- Nuk ka gjurmë të zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme, të inventarëve, etj;
- Nuk ka vlerësime të mëpasshme të AAM-ve;
- Grantet (ka raste kur respektohen kërkesat e SNK 20 kur njësia zbaton SKK-të);
- Rezerva e rivlerësimit nuk është përditësuar me aktivet e shitura e nxjerrjet jashtë përdorimit;
- Kapitali aksionar trajtuar si zë monetar në kundërshtim me SNK 21 dhe kursi i këmbimit nuk është mbajtur me datën e trasaksionit;
- Nuk njihen aktive/detyrime tatimore të shtyrë;
- Amortizimi i aktiveve bëhet me norma fiskale në kundërshtim rregullimet në standarde;
- Shoqëria njeh të ardhurat nga shërbimet sipas flukseve hyrëse dhe jo sipas % së realizimit të shërbimit;
- Etj;

Gjithësesi, në përfundim mund të thuhet se njësitet e monitoruara në pjesën më të madhe të tyre respektojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për hartimin dhe publikimin e pasqyrave


financiare, duke theksuar rezervën që monitorimi është bërë vetëm mbi pasqyrat financiare dhe jo mbi shënimet shpjeguese për arsyen që u tha më lart.

Referuar gjetjeve nga monitorimet si dhe gjetjeve të tjera të audituesve (që kanë lidhje me cilësinë e zbatimit të standardeve) të paraqitura në raportet e tyre të auditimit, KKK do të ndërtojë një plan pune për të përgatitur udhëzimet e duhura me qëllim eliminimin e këtyre të metave për aq sa ato kanë ardhur si pasojë e zbatimit të gabuar të pavullnetshëm nga ana e njësisë ekonomike.

5. Veprimtaritë dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit

5.1 BSNK, Londër

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, prej vitit 2007 është palë përfituese në kontratën “Copyright waiver” lidhur mes Ministrisë së Financave të Shqipërisë dhe Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Londër.



Burimi: <https://cdn.SNRF.org/-/media/feature/about-us/funding/annual-report-2018.pdf>

Objekti i kontratës është e drejta për të disponuar mbi baza të rregullta të gjitha publikimet e IFRS Foundation të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja apo ndryshimeve të atyre ekzistues. Gjithashtu në kontratë parashikohet edhe e drejta e publikimit të SNRF-ve të përkthyer në gjuhën shqipe pa ndryshime nga origjinali në gjuhën angleze. Për përfitimet nga kjo kontratë, Këshilli pagan një tarifë vjetore prej £ 2,000.

KKK përkthen materialet e dërguara sipas procedurave⁶ të miratuara për përkthimin dhe rishikimin e SNRF-ve. SNRF-të, përkthyer me programin profesional TRADOS dhe konsoliduar mbi baza vjetore, dërgohen në Departamentin e përkthimit pranë SNRF Foundation për publikim në faqen zyrtare⁷ të SNRF Foundation. Në janar 2019, stafi dërgoi në Departamentin e përkthimit të IFRS Foundation variantin më të fundit të konsoliduar në gjuhën shqipe, atë të SNRF-ve 2018⁸.

Gjatë vitit 2019 kanë mbërritur për përkthim vetëm ndryshimet e SNRF 9, SNRF 7 dhe SNK 39. Komiteti i Rishikimit nuk ka përfunduar akoma procesin e përkthimit dhe rishikimit. Kur materiali të dërgohet i përfunduar nga KR, stafi do të përgatisë relacionin sqarues për MFE dhe bashkë me vendimin e KKK për miratimin e përkthimit, do t'i dërgojë për shpallje tek Ministri përgjegjës për financat.

5.2 Banka Botërore

KKK-ja prej vitit 2012 është e përfshirë, në cilësinë e përfituesit, në *Corporate Financial Reporting Enhancement Project* (CFREP) të Programit REPARIS, Eorld Bank Group. Në kuadër të këtij projekti, KKK është mbështetur në vitet 2012-2019 në disa drejtime duke përmendur këtu:

- rritjen e kapaciteteve të stafit të KKK-së në lidhje me qasjen e zhvillimit të SKK-ve të reja;
- mbështetjen e stafit me konsulencë të huaj në përmirësimin e SKK-ve të publikuara në vitin 2008, për t'i bërë ato të krahasueshme me SNRF për NVM;
- mbështetjen në një afat 2 vjeçar (2013-2014) me konsulentë të huaj për hartimin për herë të parë të udhëzuesit për zbatimin e SKK-ve;
- mbështetjen teknike por dhe logjistike (2013-2014) përmes sigurimit të softwaret të përkthimit TRADOS që mundëson përkthimin e standardizuar të SNRF-ve dhe konsolidimin e tyre mbi baza vjetore;

⁶ <http://kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=119&gj=sh>

⁷ <https://www.ifrs.org/issued-standards/ifrs-translations/#other-available-translations>

⁸ Publikuar nga IFRS Foundation deri në vitin 2018

- bashkëpunimin në draftimin e dokumenteve të ndryshme si draft strategjia e zhvillimit të SKK-ve dhe përkthimit të SNRF-ve, manuali i procedurave të monitorimit të SKK-ve dhe SNRF-ve, draft raporti i performancës së OJF-ve, analiza e tabelës së përputhshmërisë me Dir 34/2013, EU, etj;
- pjesëmarrjen e përvitshme e përfaqësuesve të KKK në aktivitete që zhvillohen në kuadër të Programit REPARIS;

Gjatë vitit 2019, KKK është mbështetur me konsulencë për të draftuar dy dokumente të reja si dhe për të përditësuar një dokument të mëparshëm:

- *Metodologjia e monitorimit të zbatimit të standardeve;*
- *Raporti i Performancës së OJF-ve;*
- *Tabela e transpozimit të Direktivës 34/2013 të BE-së.*

Bashkëpunimi do të vijojë edhe në të ardhmen pasi KKK është sërish përfitues në fazën e tretë të projektit CFREP të Programit REPARIS që pritet të lanohet së shpejti.

5.3 Organizatat e profesionit

KKK-ja si një rregullator në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me të gjitha organizatat profesionale, ato të kontabilistëve dhe audituesve, IEKA, IKM, SHKFSH dhe SHKM.

Këto bashkëpunime datojnë shumë shpejt pas krijimit të KKK-së. Bashkëpunimi ka qenë i fokusuar, por pa u limituar vetëm në to, kryesisht në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, ndërshkëmbime të eksperiencës dhe ekspertizës institucionale, ndërtimin e kurikulave të trajnimeve, në propozime për projektin e përbashkët të rradhës, etj. Fryma e bashkëpunimit ka ndikuar pozitivisht jo vetëm në rritjen e cilësisë dhe imazhit të të gjithë aktorëve të përfshirë por në përgjithësi dhe të implementimit me sukses të reformës në fushën e raportimit financiar.

6. Objektivat për të ardhmen

Objektivi kryesor i KKK-së është përmirësimi i vazhdueshëm i raportimit financiar të njësive ekonomike subjekt i zbatimit të ligjit nr 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmirësimi i raportimit financiar ka në fokus përmirësimin e përmbajtjes dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit të vlefshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare me qëllim të përgjithshëm.

- *Pasqyrat financiare* – përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare;
- *Shënimet shpjeguese* – rishikimi i shënimeve shpjeguese për njësitë ekonomike të vogla dhe përmirësimi i efektivitetit të shënimeve shpjeguese për njësitë e mesme ekonomike në përgjigje të interesimit të hartuesve të pasqyrave financiare dhe investitorëve;
- Hartimi i komentareve për raportet e tjera jofinanciare që ndihmojnë investitorët në vlerësimin e njësisë ekonomike në lidhje me qëndrueshmërinë e vijimësisë dhe drejtimit, përfshirë informacion të mjaftueshëm mbi çështje sociale, të qeverisjes së mirë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

➤ Prioritetet strategjike dhe operacionale

Detyrat e KKK janë përcaktuar në Ligjin nr 25, datë 10.05.2018. Këto detyra janë përkthyer në një plan të qartë të përparësive operacionale, të përbërë nga tre shtylla. Ky plan operacional siguron që aktivitetet e përditshme të KKK-së të jenë plotësisht në përputhje me objektivin e përgjithshëm.

Hartimi dhe përmirësimi me cilësi të lartë i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit – KKK mbështetet në programin e punës, sigurohet që janë respektuar kërkesat e procesit të hartimit dhe përmirësimit të standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe sigurohet që të gjitha grupet e interesit të jenë të përfshirë në procesin e hartimit / përmirësimit të standardeve.

Mbështetja e implementimit dhe zbatimi i qëndrueshëm i SKK-ve – KKK mbështet implementimin e standardeve të reja ose përmirësimeve të tyre; përmirëson në vazhdimësi standardet kombëtare të kontabilitetit përmes një procesi efektiv për të përjashtuar çdo paqëndrueshmëri apo papajtueshmëri në praktikën e zbatimit të tyre; bashkëpunon me Bankën

Botërore dhe donatorë të tjerë për të gjetur mbështetjen e tyre në iniciativa që lidhen drejt për drejt me përmirësimin e raportimit financiar por që kërkojnë angazhime të konsiderueshme financiare; harton në vazhdimësi udhëzues dhe materiale të tjera edukimi, organizon dhe merr pjesë në aktivitete të ndryshme me fokus çështjet e raportimit financiar.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për kontabilitetin, KKK ka përgjegjësinë të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit. Në këtë kuadër është duke draftuar metodologjinë e monitorimit të standardeve, dokument i cili do të miratohet dhe vihet në zbatim gjatë vitit 2020. Metodologjia do të jetë e zbatueshme për pasqyrat financiare 2019 e në vijim. Monitorimi do të jetë një burim shumë i mirë informacioni për të kuptuar dhe siguruar cilësinë e standardeve dhe zbatueshmërinë e tyre nga njësitë ekonomike.

Përkthimi i SNRF-ve – KKK organizon, në kohë dhe me cilësi, punën për përkthimin e SNRF-ve në gjuhën shqipe pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze. Komiteti i Rishikimit i përgjigjet me shumë korrektesë detyrës që ka marrë përsipër. Në procesin e përkthimit përdoret një software shumë i avancuar përkthimi që përkthehet nga organizmat më të rëndësishëm ndërkombëtarë të fushës. Megjithatë, për shkak të fondeve të kufizuara që ka në dispozicion, programi që aktualisht përdoret nga KKK është i vitit 2011. Sot përdoret masivisht varianti TRADOS Studio 2019. Ky fakt i krijon probleme të shumta në punën e përditshme përkthyesve dhe stafit të KKK por gjithësesi deri tani ka qenë e mundur të sistemohet çdo problem por në vijim problematikat do të bëhen të tilla që do të pengojnë ecurinë normale të përkthimit dhe konsolidimit të SNRF-ve. KKK do të shohë mundësinë në donatorë të tjerë, përveç fondeve buxhetore, të krijojë mundësinë të përditësojë paketën e përkthimit.

Praktika e punës me SNRF-të është e tillë që ndryshimet e publikuara nga BSNK përkthehen, rishikohen, miratohen nga KKK dhe dërgohen për shpallje tek Ministri përgjegjës për financat. Ky proces kërkon mesatarisht një periudhë kohe jo më pak se tre muaj. Në vitin pasardhës të ndryshimeve, stafi i KKK përgatit variantin e konsoliduar për ta publikuar atë në faqen zyrtare të internetit të KKK-së.

Organizimi efektiv – KKK është një organizëm publik, profesional, i pavarur që funksionon me fonde buxhetore. Aktiviteti që kryen është tërësisht në përputhje me rregullimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fondet në dispozicion janë shumë modeste ndaj KKK organizohet në mënyrë të tillë që të jetë shumë efektive duke i orientuar fondet në aktivitetet dhe produktet me efektivitetin më të madh. Stafi i KKK-së është i vogël në numër dhe me një fushë specializimi.

Ai ka në përbërjen e tij vetëm nëpunës me formim në shkencën e ekonomisë. Është shumë e rëndësishme që stafi të rritet në numër duke përfshirë edhe specializime të tjera si nëpunës me formim në shkencat juridike, në shkencat e komunikimit dhe në shkencat e teknologjisë së informacionit. Burime të tilla do të ishin vlerë e shtuar për stafin e KKK-së. Me rregullimin aktual, shtimi i organikës nuk është i mundur. KKK parashikon të propozojë një organigramë të re në strukturat përkatëse vendimmarrëse ku do të argumentohen përfitimet dhe kostot e ndryshimeve përkatëse.

Gjithashtu, KKK vlerëson se realizimi i më shumë detyrave kërkon përveçse më shumë staf por edhe mbështetje me logjistikë. Hapsirat (zyrat) ku KKK zhvillon aktivitetin janë shumë të kufizuara, teknologjia nuk është e përditësuar, pajisjet informatike janë të amortizuara dhe ka mungesa të pajisjeve të zyrës për post pune.

Në kuadër të rikonceptimit të pozicionit të KKK si një organizëm shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit, KKK përveç propozimit për rritjen e stafit do të paraqesë kërkesën për të përmbushur edhe nevojat e tjera, në funksion të përmirësimit të cilësisë së detyrave që kryen për realizimin e misionit të vet.

Transpozimi i Acquis Communautaire – Vendi ynë, si vend kandidat për anëtarësimin në BE, ka për detyrë transpozimin e legjislacionit të BE duke ndryshuar legjislacionin vendas. Në këtë kuadër, KKK si një organizëm publik që rregullohet me ligj të veçantë, ka përgjegjësinë të angazhohet në transpozimin e Direktivës së kontabilitetit në BE, Dir 34/2013 të ndryshuar duke propozuar ndryshime të mëtejshme ligjore apo duke përfshirë kërkesa të Direktivës në setin e standardeve të kontabilitetit. Kjo është një detyrë që KKK e ka kryer me shumë korrektesë dhe angazhim në fazën e draftimit të ligjit të ri të kontabilitetit dhe do të punojë për një ndërhyrje të dytë në një periudhë afatmesme. Ndërsa rishikimet e standardeve në kuadër të kërkesave të Direktivës janë një fokus i vazhdueshëm i KKK-së.

7. Plani i punës 2020

Në mbledhjen e fundit për vitin 2019 u përcaktuan edhe detyrat që do të realizojë Këshilli gjatë vitit 2020. Produktet e pritshme, por pa u limituar vetëm në to, janë si më poshtë:

- Përgatitja e Raportit të Veprimtarisë 2019;
- Programi i punës për vitin 2020;

- Raporti i performancës së OJF-ve;
- Publikimi i variantit të konsoliduar të SNRF-ve 2019;
- Manuali i procedurave për monitorimin e zbatimit të standardeve të kontabilitetit;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit të KKK-së me Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit të KKK-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse të KKK-së në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e KKK”;
- Udhëzuesi për plotësimin e pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;
- Rishikimi i kërkesave ndaj njësisve ekonomike të vogla për shënime shpjeguese në përputhje me sa parashikohet në Dir 34/2013/EU;
- Përmbyllja e analizës së tabelës së përputhshmërisë (*mes kuadrit shqiptar të raportimit financiar dhe Dir 34/2013/EU*) me synim identifikimin e hapave pasues drejt transpozimit të plotë;
- Kodi i Etikës së KKK-së - në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e KKK-së”;
- Rishikimi i udhëzuesit për zbatim të SKK 4 *Inventarët*;
- Rishikimi i udhëzuesit për zbatim të SKK 5 *Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale*;
- Rishikimi i udhëzuesit për zbatim të SKK 7 *Qiratë*;
- Rishikimi i udhëzuesit për zbatim të SKK 9 *Kombinimi i bizneseve dhe Konsolidimi*;
- Rishikimi i udhëzuesit për SKK 13 *Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare*;
- Miratimi i Kodit të Etikës së KKK-së;
- Tryezë e rumbullakët “Zbatimi i kërkesave të ligjit të ri të kontabilitetit për raportet e reja jofinanciare”;
- Takime studentore / Tryeza të rumbullakëta;
- Hartimi i Projekt Idesë për programe afatmesme të KKK-së.
- Përgatitja e një dokumenti orientues për njësitë ekonomike që zbatojnë SKK-të, në fazën e përgatitjes së pasqyrave financiare (check list i zërave të paraqitur në pasqyrat financiare dhe paragrafëve përkatës në SKK);
- Raportime peroidike të monitorimeve të pasqyrave financiare;

Për të gjitha detyrat e parashikuara për vitin 2020 është ndërtuar gjithashtu një plan i detajuar me afate dhe ndarje përgjegjësish. Stafit do të raportojë në mbledhjet e radhës për çfarë është realizuar, sfidat, aktivitetet, rezultatet dhe impaktin e tyre. Rezultat e arritura do të jenë një pikë referimi për reflektime të mëtejshme në ndërtimin e objektivave, strategjive dhe planeve të punës së KKK-së.

Në shtojcat më poshtë paraqiten disa informacione të tjera që kanë të bëjnë me treguesit e buxhetit, të sistemit të kontrollit të brendshëm, të auditimit të kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MFE si dhe detyra të tjera administrative të kryera nga stafi i KKK-së si pjesë e administratës shtetërore.

Shtojcë A- Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare

➤ Realizimi i buxhetit 2019

Me ligjin Nr. 99/2018 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” u miratua buxheti i vitit 2019 për KKK, i cili u dërgua i detajuar me shkresë Nr. 18366/2 datë 17.01.2019, dhe paraqitet si më poshtë vijon:

Emërtimi i institucionit		Llog. Ekonomike		Plani i vitit 2019 Në lekë
1	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	600	Pagat	6,250,000
2	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	601	Sig. Shoqërore	1,250,000
3	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	602	Shpenz. Operative	3,720,000
4	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	605	Transferta me jashtë	300.000
5	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	231	Investime	1,000,000
TOTALI				12,520,000

Realizimi i buxhetit 2019 rezulton si më poshtë vijon:

Llogaria 600 - 601	71%
Llogaria 602	47%
Llogaria 605	99%
Investime	26%

Fondi i pagave dhe i sigurimeve i planifikuar për vitin 2019 mbante në konsideratë numrin e plotësuar të stafit gjë që nuk u verifikua gjatë vitit. Një prej punonjësve u largua me leje lindje ndërsa punonjësi tjetër u rekrutua në fund të vitit 2019.

Llogaria 602 “Shpenzime korente” nuk u realizua në masën e parashikuar sepse për disa zëra nuk u verifikua ndodhja e tyre për shkaqe objektive:

- Fondi për shpërblimin e anëtarëve të KKK nuk u përdor në masën e parashikuar sepse gjatë vitit 2019 së pari nuk u zhvilluan të gjitha mbledhjet e parashikuara dhe së dyti numri i anëtarëve të emëruar të KKK-së mbeti i paplotësuar;

- Fondi i parashikuar për pagesën e përkthyesve të SNRF-ve të ndryshuara nuk u përdor sepse ndryshimet e bëra nga Bordi i Londrës ishin një volum shumë më i vogël se ai i parashikuar apo ai i verifikuar në vite të mëparshme;

- Fondi i parashikuar për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare nuk u përdor sepse asnjë nga anëtarët dhe stafi i KKK-së nuk mori pjesë në aktivitetin kryesor ndërkombëtar, në Konferencën vjetore të BSNK, Londër, për shkak të situatës së rënduar të tërmetit;

- Fondi i planifikuar për botime nuk u përdor pasi KKK mori gjatë vitit vendimin të mos ribotojë tekstin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit pasi vendosi të rishikojë pjesën më të madhe të udhëzuesve të këtyre standardeve. Botimi i tekstit do të bëhet pas rishikimit.

- Fondi për shpenzime utilitare (uje, energji, telefon) nuk u përdor në masën e parashikuar. Kjo diferencë është mbajtur parasysht në planifikimin e fondeve për vitin 2020.

Llogaria 231- Fondi i parashikuar për investime nuk është realizuar sepse nuk u bënë blerjet e parashikuara për pajisje zyre dhe informatike për dy nëpunës (një me leje lindje dhe tjetri u rekrutua në fund të vitit). Investimi është parashikuar në fondet e vitit 2020. Gjithashtu, në llogaritjen e fondit për investime ishte parashikuar blerja e një serveri me kapacitet më të madh në mënyrë që të garantohet siguria e informacionit dhe memories së programit të përkthimit por

blerja nuk u realizua për shkak se u kufizua përdorimi i fondeve pas ngjarjes së tërmetit të muajit nëntor.

Pasqyrat financiare (*shih Aneks I*), të hartuara për periudhën raportuese 2019, u dorëzuan në fund të muajit shkurt 2020 në Ministrinë përgjegjëse për financat dhe Degën e Thesarit Tiranë.

➤ **Parashikimi buxhetor 2020**

Me ligjin Nr. 88/2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020” u miratua buxheti i vitit 2020 për KKK, i cili u dërgua i detajuar me shkresë Nr. 24325/4 datë 30.12.2019, dhe paraqitet si më poshtë vijon:

Emërtimi i institucionit		Llog. Ekono mike		Plani i vitit 2020 Në lekë
1	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	600	Pagat	7,000,000
2	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	601	Sig. Shoqërore	1,500,000
3	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	602	Shpenz. Operative	3,270,000
4	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	605	Transferta me jashtë	350,000
5	Këshilli Komb. i Kontabilitetit	231	Investime	1,000,000
TOTALI				13,120,000

Në kushtet kur Qeveria po rishikon Buxhetin 2020 me qëllim përballimin e situatë së krijuar nga Covid 19, KKK reflektoi për situatën duke rishikuar gjithashtu buxhetin e vet dhe duke e reduktuar atë përkatësisht me 1,000,000 lekë për shpenzimet korente dhe me 500,000 lekë për shpenzimet kapitale, si më poshtë:

Llogari	Përshkrimi	Shuma
600	Paga	7,000,000
601	Kontribute	1,500,000
602	Shpenzime korente	2,270,000
605	Transferta me jashtë	350,000
231	Investime	500,000
Totali		11,620,000

Shtojcë B - Rezultate dhe rekomandime të auditimit të brendshëm të MFE

Në janar të vitit 2019, MFE dërgoi njoftimin për ngritjen e grupit të auditimit të brendshëm me fokus angazhimi:

- Auditimin e sistemeve – Vlerësimi i kontrollit të brendshëm
- Auditimi i përputhshmërisë – respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë: (1) funksionimin dhe organizimin e KKK-së, (2) zbatimin e procedurave të planifikimit dhe realizimit të prokurimeve publike dhe (3) menaxhimin e burimeve njerzore, përfshirë sistemin e pagave.
- Auditimi financiar – rregullat për: (1) hartimin dhe miratimin e buxhetit 2016-2018, (2) kryerjen e shpenzimeve dhe respektimin e limiteve të tyre, (3) mbajtjen e kontabilitetit, inventarizimet, përgatitjen e pasqyrave financiare.

Periudha e audituar janë vitet 2016-2018 dhe afati i kryerjes së auditimit ishte 07-25 janar 2019. Në fund të auditimit, KKK-së i'u dërgua raporti përfundimtar i auditimit me rekomandimet përkatëse si më poshtë:

- Kryetari i KKK-së të marrë masa të plotësojë organikën e stafit;
- KKK të përditësojë rregulloren e brendshme të rekrutimit të stafit duke e përshtatur atë me kërkesat e ligjit “Për nëpunësin civil”;
- Për çdo blerje të ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve dhe të hartohet PV i marrjes në dorëzim ku të specifikon të dhënat e aktivitetit të prokuruar;
- Nëpunësi Zbatues njofton mbi baza mujore Nëpunësin Autorizues për realizimin e fondeve buxhetore të ndara në shpenzime korente (602) dhe shpenzime kapitale (231).
- Të sistemohet shuma derdhur tepër në llogarinë e Degës së Tatim Taksave Tiranë.

Rekomandimet e grupit të auditimit të brendshëm u pranuan nga KKK dhe u hartua plani i masave për zbatimin e tyre. Në fund të vitit 2019 rezultojnë të realizuara si më poshtë:

- Në muajin tetor 2019 u plotësua organika e KKK-së;
- Të gjitha blerjet (aktivet) 2019 janë të shoqëruara me PV e marrjes në dorëzim të tyre të përgatitur nga komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve të prokuruar;
- Nëpunësi zbatues raporton rregullisht mbi baza mujore për fondet buxhetore;

Përditësimi i rregullores së brendshme për rekrutimin e stafit është në proces sepse 6 mujori i dytë 2019 përkoi me daljen e Rregullores së Re të Organizimit dhe Funksionimit të KKK-së si dhe me përfundimin në bllok të mandateve të anëtarëve ekzistues dhe emërimin e anëtarëve të rinj të KKK-së. Rregullorja e përditësuar e rekrutimit të stafit të KKK do të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2020.

Ndërsa sistemimi i shumës së derdhur tepër nga KKK në llogarinë e Degës së Tatim Taksave është bërë nga vetë DRTT duke kompensuar të tjera detyrime për taksa derdhur më pak nga KKK në periudha e mëvonshme.

Shtojcë C - Pyetësi për vetvlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2018

Nga ana e stafit të KKK plotësohet çdo vit pyetësi i vetvlerësimit i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin paraardhës. Ky pyetësor dërgohet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (është i disponueshëm dhe në faqen e internetit të MFE) dhe është i detyrueshëm për t'u dorëzuar çdo datë 1 Mars.

Ky dokument tregon përgjegjësitë kryesore të Nëpunësit Autorizues në kuadrin e implementimit të konceptit të përgjithshëm menaxherial. Me anë të tij bëhet vetvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm brenda institucionit.

Ky pyetësor ka pesë komponentë:

- 1.Mjedisi i kontrollit
- 2.Menaxhimi i riskut
- 3.Aktivitetet e kontrollit
- 4.Informimi dhe komunikimi
- 5.Monitorimi

Deklarata, raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2018 dhe plani i ngritjes dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Pas plotësimit të pyetësit të mësipërm për vitin 2018, Nëpunësi autorizues hartoi deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për institucionin. Në deklaratë

Nëpunësi autorizues deklaron përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jofinanciare të njësisë, monitorimin që i ka bërë sistemit të kontrollit të brendshëm të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit gjatë vitit raportues 2018 duke krijuar një mjedis kontrolli, menaxhimi të riskut, veprimtarisë së kontrollit, nëpërmjet marrjes së informacioneve dhe komunikimeve të vazhdueshme me vartësit, nëpërmjet vlerësimeve dhe analizave në vazhdimësi, nëpërmjet vendosjes së një sistemi rregullash dhe procedurash të brendshme të njësisë.

ANEX 1 – Pasqyrat financiare për vitin 2019

Pasqyrat financiare vjetore janë ndërtuar në përputhje me Udhëzimin⁹ nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së përgjithshme”.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Nr. Reshti	Llog	EMERTIMI	VITI 2019 Ushtrimi Mbyllur	VITI 2018 Ushtrimi Paraardhes
1	A	AKTIVET	2,127,296	2,043,239
2		I.Aktivët Afat shkurtra	981,808	963,029
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	0	0
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar		
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	248,393	501,559
12	31	Materiale		
13	32	Inventar l imet		
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra	248,393	501,559
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	733,415	461,470
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetstore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike	16,968	14,718
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem		

⁹ http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Udhezimi_nr.8_date_09.03.2018_Per_Procedurat_e_Pergatitjes_Paraqitjes_dhe_Raportimit_te_Pasqyrave_Financiare_Vjetore_te_NJQP.pdf

33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	716,447	446,752
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per zhvlresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		II.Aktivet Afat gjata	1,145,488	1,080,210
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	770,121	913,410
48	210	Toka, Troje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione		
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje		
53	215	Mjete Transporti		
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik (vlerë e mbetur)	770,121	913,410
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	375,367	166,800
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale (vlerë e mbetur)	429,495	166,800
	209	Amortizimi pë AAM investime	-54,128	

65	B	PASIVET(DETYRIMET)	733,411	461,470
66		I.Pasivet Afat shkurtra	733,411	461,470
67		1. Llogari te Pagushme	716,443	446,752
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	15,316	13,568
69	42	Detyrime ndaj personelit	431,096	278,725
	421	Detyrime honorare Bordi	63,750	
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa (TAP)	57,667	61,530
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	130,321	81,171
76	436	Sigurime Shendetstore	18,293	11,758
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		

78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje		
82	467	Kreditore te ndryshem		
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	16,968	14,718
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese	16,968	14,718
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		

96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,393,885	1,581,769
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,393,885	1,581,769
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,581,769	1,621,963
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	-187,884	-40,194
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		

108	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	2,127,296	2,043,239
-----	----------	--------------------------------	------------------	------------------

PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE

(Klasifikimi i shpenzimeve sipas Natyrës ekonomike)

Nr.	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR 2019	VITI MEPARSHEM 2018
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	7,890,390	7,449,090
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel		
7	7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	0	0
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme		
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	0	0
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	0	0

35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0	0
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	0	0
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh		
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimet valutore		
53	72	V.GRANTE KORENTE	7,890,390	7,449,090
54	720	1.Grant korent I Brendshem	7,890,390	7,449,090
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	7,173,943	7,002,338
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim i pritshem nga buxheti	716,447	446,752
62	7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)		
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	2.Grant korent I Huaj	0	0
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni i investimeve		
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	8,078,271	7,489,284
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	4,759,131	4,335,600

76	6001	Paga, personel i perhershëm	4,759,131	4,335,600
77	6002	Paga personel I Perkohshëm		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	785,817	699,735
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	704,912	626,030
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	80,905	73,705
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	1,785,741	2,111,355
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme		
	60201	Kancelari	118,539	113,995
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale		
87	6022	<i>Sherbime nga te trete</i>		
		Energjia	85,064	88,593
		Ujë	8,590	6,550
		Telefoni dhe internet	136,436	136,969
		Shërbime postare	785	1,628
		Shërbime bankare	6,083	3,113
		Shërbime pastrimi	117,600	107,801
88	6023	Shpenzime transporti		
89	6024	<i>Shpenzime udhetimi</i>		
		Udhëtime brenda vendit		54,397
		Udhëtime jashtë vendit	15,305	246,099
90	6025	<i>Shpenzime per mirembajtje te zakonshme</i>		
		Shpenzime per mirembajtje zyre		110,320
		Shpenzime mirëmbajtje pajisje zyre	35,800	11,600
91	6026	Shpenzime per qeramarrje		
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	<i>Shpenzime te tjera operative</i>	3,012	
		Honorare të Bordit dhe të përkthyesve	1,045,000	1,130,000
		Shpenzime organizim konference	198,527	85,290
		Taksa vendore	15,000	15,000
95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
96	6030	Subvecione per diference cmimi		
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecione te tjera		
101		V.TRANSFERIME KORENTE	297,000	302,400
102	604	1.Transferime korente te brendshme	0	0
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	605	2.Transferime korente me jashte	297,000	302,400

108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	297,000	302,400
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	0	0
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	197,417	0
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit	197,417	
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	253,165	40,194
131		IX.SHPENZIME TE TJERA	0	0
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	-187,881	-40,194

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

(Sipas Metodës direkte)

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse 2019	Periudha Paraardhese 2018
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	0	0
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	7,357,059	7,536,775
3	2	Arketime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor	0	0
4		Te hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)		
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)		
7		Te hyra, sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)		
10		Te tjera, arketuar(+)		
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	-7,357,059	-7,536,775
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara (-)	-446,752	-451,163
13		Per detyrime e shpenzime te viti ushtrimor (-)	-6,910,307	-7,085,612
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje (-)		
15		Interesi I paguar (-)		
16		Tatime te paguara (-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	0	0
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	262,695	166,800
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-262,695	-166,800
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	0	0
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
30		Transferime ne buxhet te Fondevete pa perdorura(-)		
31		Levizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)		
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	0	0
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	0	0
34	VI	Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor	0	0

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE AKTIVET NETO/ FONDET NETO

Viti 2019

Nr	Referencë	EMËRTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerva	Fonde të tjera të veta	Rezultatet e mbartura	Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/ Deficit	Gjithsej Aktive neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6
1	101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	1,581,769					1,581,769
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	0	0	-187,884	0	0	-187,884
3		1. NGA BURIME TE BRENDSHME	0	0	-187,884	0	0	-187,884
4	105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	0					0
5	1016 , 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					0
6	1014 , 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0					0
7	12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)						0
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor (+,-)	0					0
9	111	Nga Rezervat (+,-)	0					0
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	0		262,695			262,695
11	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)	0		-253,162			-253,162
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	0		-197,417			-197,417
14	1015	Nga nxjerrjet jashteperdorimit dhe demtimet(-)	0					0
15	107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne perdorim(+,-)	0					0
16	109	Diferenca nga Rivleresimi I AAGJ(+,-)	0					0
17		2. NGA BURIME TE JASHTME	0	0	0	0	0	0
18	106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	0					0
19	1016 , 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					0
20		TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	1,581,769	0	-187,884	0	0	1,393,885